



Për Reduktim nga Tarifa e shkollimit për studentët e ciklit të dytë për vitin akademik 2025-2026.

Në zbatim të VKM-ve;

VKM Nr. 780, datë 26.12.2018 (Cikli II); "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programe të ciklit të dytë të studimeve në institucionet publike të Arsimit të Lartë"; dhe që ju përkasin kategorive sociale sipas përcaktimeve në VKM Nr. 269, datë 29.03.2017, (ndryshuar) dhe VKM Nr. 780, datë 26.12.2018, duhet të plotësojnë dokumentacionin sipas tabelës më poshtë, për përfitim / reduktim nga tarifa e shkollimit për vitin akademik 2025- 2026.

Dokumentacioni i nevojshëm që duhet të dorëzojnë studentët për Reduktim 50% (Cikli i dytë) 2025-2026

Shënim: Dokumentacioni që ofrohet nga e-albania nuk ka nevojë të tërhiqet në zyrat përkatëse

N r	Kategoria	Dokumentacioni i nevojshëm i studentit
1	Studentët me aftësi të kufizuara, të vërtetuar me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë	- Kopje ID - Vërtetim i pagesës nga DRSSH - Noterizim i vendimit të K.M.C.A.P
2	Studentët fëmijë të personave/familjes me aftësi të kufizuara, të vërtetuar me vendim të KMCA-së për punë, familjet e të cilëve trajtohen/përfitojnë nga ligji nr. 9355, datë 10.3.2005,	- Çertifikatë familjare - Kopje ID - Vërtetimi pagesës nga DRSSH - Noterizim i vendimit të KMCA.P për prindin me aftësi të kufizuar.
3	Studentët, familjet e të cilëve trajtohen/përfitojnë ndihmë ekonomike të plotë apo të pjesshme nga njësitë bazë të vetëqeverisjes vendore	- Çertifikatë familjare - Kopje ID - Vërtetim nga Njësia administrative vendore që familja e studentit trajtohet me ndihmë ekonomike
4	Studentët deri në moshën 25 vjeç, që kanë vetëm njërin nga prindërit, pasi prindi tjetër është ndarë nga jeta, me të ardhura vjetore të familjes të pamjaftueshme për përballimin e kostos së studimeve;	- Çertifikatë familjare - Kopje ID - Dokumentacion financiar që tregon gjendjen financiare të familjes së studentit / es
5	Studentët, që kanë përfituar statusin e jetimit, deri në moshën 25 vjeç;	- Kopje kartë indentiteti - Libreza e statusit të jetimit lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror (Bazuar në ligjin Nr.8153, datë 31.10.1996, "Për statusin e Jetimit", Përfitojnë statusin e jetimit personat me moshë nga 0-25 Vjeç dhe që plotësojnë këto kriterë: a) të lindurit jashtë martese; b) që nuk kanë gjallë asnjërin nga prindërit; c) të cilëve me vendim të formës së prerë të gjykatës u është hequr e drejta prindërore e të dy prindërve ose u është hequr e drejta prindërore për njërin prind dhe prindi tjetër nuk jeton; d) që braktisen nga të dy prindërit dhe nuk u njihet identiteti i tyre.
6	Studentët deri në moshën 25 vjeç, që kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykatë të formës së prerë;	- Çertifikatë familjare - Kopje ID - Vendim gjykatë të formës së prerë
7	Studentët deri në moshën 25 vjeç, që janë identifikuar si viktimë të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë përfituar statusin ligjor për trajtim si viktimë të trafikut të qenieve njerëzore;	- Kopje ID - Vërtetim nga Ministria përkatëse.
8	Studentët fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, të SHMZSH, të Forcave të Armatosura, të SHISH dhe të Policisë së Burgjeve, që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës, të konfirmuar nga ministria/institucioni përgjegjës;	- Kopje ID - Shkresa nga Ministria përkatëse.
9	Studentët romë dhe ballkano-egjiptianë, të konfirmuar si të tillë nga ministria përgjegjëse për mbrojtjen sociale;	- Kopje ID - Deklaratë noteriale ku deklaron statusin i shoqëruar me Vërtetimin e shoqatës rome apo ballkano-egjiptiane
10	Studentët fëmijë të ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist ose fëmijë me prindër të dënuar politikë me heqje lirie;	- Çertifikatë familjare - Kopje ID - Vërtetim nga instituti i të përndjekurve politikë

11. Studentët me mesatare 9-10

Studentët që fillojnë vitin e parë të ciklit të dytë të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë dhe që kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë me notën mesatare vjetore 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë); si dhe Studentët që rezultojnë me notën mesatare vjetore 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë), të regjistruar në vitin e parë pas të parit dhe që kanë shlyer të gjitha detyrimet akademike të parashikuara për vitin akademik paraardhës.

Listat e studentëve përfitues vijnë nga Sekretaria Mësimore.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I EKONOMISË



**Dokumentacioni dorëzohet pranë Degës së Shërbimeve FE-UT (kati i dytë godina 3-katëshe A) brenda datës 14 nëntor 2025
ora 9:00-15:00**

Email: degasherbimeve@feut.edu.al